



Në bazë të nenit 35, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16, gusht 2010), nenit 85 dhe nenit 114 të Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2016, ka miratuar si në vijim:

## **RREGULLORE PËR INSTRUMENTET DHE MARRËVESHJET E GARANTIMIT NË MES INSTITUCIONEVE TË LICENCUARA FINANCIARE DHE FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (këtu e tutje FKGK) është themeluar në përputhje me Ligjin nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 2/2016, 8 janar 2016 (këtu e tutje LFKGK) për të lehtësuar rritjen e qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (këtu e tutje NMVM) në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjes së prodhimit vendor dhe shërbimeve me vlerë të shtuar si dhe për të përmirësuar bilancin tregtar dhe për të rritur mundësitë e financimit të NMVM-ve më pak të shërbyera.
2. FKGK-ja ofron garanci kreditore për institucionet financiare të licencuara që janë të kualifikuara, siç është përcaktuar në LFKGK-së, mbi kreditë e përzgjedhura për NMVM-të. Në mënyrë që FKGK-ja të lëshojë garanci të tilla, duhet të zbatohet një instrument apo marrëveshje për garanci në mes të FKGK-së dhe çdo institucioni përkatës financiar. Kjo Rregullore përcakton zërat që duhet përfshirë në instrumente dhe marrëveshje të tilla.
3. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha instrumentet dhe marrëveshjet e garancisë që arrihen mes FKGK-së dhe bankave, degëve të bankave të huaja, institucioneve mikrofinanciare, dhe institucioneve financiare jo-bankare që janë të licencuara dhe regjistruara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës (këtu e tutje institucionet e licencuara).

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, janë përdorur përkufizimet e mëposhtme:
  - (a) **Garantues:** FKGK;

- (b) **Garancia:** zotimi i bërë nga FKGK-ja ndaj një institucioni të licencuar që të paguaj një pjesë të shumës së kryegjësë së obligimit të një debitori për atë institucion të licencuar në rast të mos-pagesës nga debitori, në përputhje me marrëveshjen kreditore në mes të debitorit dhe institucionit të licencuar, pas përbarimit dhe mbledhjes nga institucioni financiar, sipas afateve dhe kushteve të marrëveshjes apo instrumentit të garantimit të arritur mes FKGK-së dhe institucionit të licencuar.
- (c) **Marrëveshja kreditore:** çdo kontratë ligjore në përputhje me të cilën një institucion i licencuar siguron financimin për një NMVM që është klient i atij institucioni;
- (d) **Debitori:** NMVM-të klient, financimi i të cilave nga ana e institucionit të licencuar garantohej nga FKGK-ja;
- (e) **Institucioni i licencuar:** institucioni i licencuar që do të pranoj shumën e dakorduar nga FKGK-ja në rast të mos-pagesës nga ana e debitorit;
- (f) **Mos-pagesa:** çfarëdo rasti i specifikuar në marrëveshjen kreditore të arritur në mes të debitorit dhe institucionit të licencuar që rezulton me mospagesë apo pamundësi të debitorit që të përmbushë obligimin e tij ndaj institucionit të licencuar siç është dakorduar në marrëveshjen kreditore.

### **Neni 3**

#### **Informatat e detyrueshme në marrëveshjet dhe Instrumentet për garantimin kreditor**

1. Një instrument apo marrëveshje për garantimin kreditor e lidhur mes institucionit të licencuar dhe FKGK-së do të përmbaje dispozitat në vijim:

**1.1. Identitetin e palëve të marrëveshjes:** FKGK-ja dhe institucioni i licencuar;

**1.2. Kushtet sipas të cilave FKGK-ja do t'i përmbahet garantimit;**

(a) Në rast të mos-pagesës nga debitori, siç përcaktohen në marrëveshjen kreditore

(b) Njoftimi për një gjë të tillë me shkrim tek FKGK-ja nga ana e institucionit të licencuar;

(c) Periudhën kohore brenda së cilës duhet të bëhet njoftimi;

(d) Vërtetimin nga institucioni i licencuar që përcakton se:

- (i) ka parashtruar kërkesën me shkrim tek huamarrësi duke kërkuar pagesën e plotë të të gjithë shumës së papaguar;
- (ii) ka ndjekur me kujdes të gjitha mjetet e lejueshme ligjore për përbarimin dhe mbledhjen e shumës; dhe

- (iii) ka shlyer gjithë bilancin e mbetur të papaguar të kryegjësë së kredisë si shpenzime të borxhit të keq;

**1.7. Përqindja e garancisë:** Përqindja e shumës së mbetur të papaguar të kryegjësë së borxhit apo obligimet tjera që FKGK-ja dakordohet t'i paguajë institucionit të licencuar në rast të mos-pagesës nga debitori, e cila nuk mund të kalojnë pesëdhjetë (50%) të shumës së mbetur të papaguar të kryegjësë pas përmbartimit dhe mbledhjes;

**1.8. Kufizimi i detyrimit:** Është dispozita sipas së cilës detyrimi i FKGK-së në kuadër të instrumentit apo marrëveshjes së garancisë nuk do të tejkalojë përqindjen e specifikuar në instrumentin apo marrëveshjen e garancisë

**1.9. Valuta e përdorur për garancinë dhe tarifatat e garancisë :** Euro;

**1.10. Tarifatat e garancisë:** Dispozita në lidhje me pagesën e tarifave nga institucioni i licencuar tek FKGK-ja, duke përfshirë:

- (a) Shumën e këtyre tarifave, apo mënyrën se si ato do të llogariten;
- (b) pasojat e mospagesës së këtyre tarifave me kohë, përfshirë edhe të drejtën e FKGK-së që me zgjedhjen e saj dhe pas njoftimit me shkrim tek institucioni i licencuar të ndërpresë apo pezullojë (dhe rrjedhimisht të ndërpres, sipas diskrecionit të saj) instrumentin apo marrëveshjen për garanci, dhe pas ndërprerjes apo pezullimit të tillë të mos ketë obligime tjera ndaj institucionit të licencuar sipas instrumentit apo marrëveshjes së garantimit, duke ruajtur të drejtën që të mbledh tarifatat e paguara;

**1.11. Zëvendësimi:** Dispozitë në rast se FKGK-ja obligohet të bëjë pagesa për garancinë, atëherë FKGK-ja zëvendësohet me institucionin e licencuar deri në shkallën për të cilën FKGK-ja ka paguar garancinë dhe mund të ndjek çdo mjet ligjor ndaj debitorit që do të mund të kishte ndjekur institucioni i licencuar sipas marrëveshjes kreditore, me kusht që:

- (a) dispozita e zëvendësimit të mos përjashtojë FKGK-në nga ndjekja e mjeteve ligjore në dispozicion të institucionit të licencuar, apo institucionin e licencuar nga ndjekja e mjeteve ligjore në dispozicion ndaj debitorit, në përputhje me marrëveshjen e kredisë;
- (b) Nëse FKGK-ja ka paguar kërkesën sipas instrumentit apo marrëveshjes së garancisë, dhe institucioni i licencuar pranon apo rikthen fondet që ndërlidhen apo përmbushin shumën e kryegjësë të cilën debitori i detyrohet sipas marrëveshjes së kredisë, atëherë institucioni i licencuar menjëherë do të rimbursojë FKGK-në në bazë "pro rata" para zbritjes së shpenzimeve apo shumave të tjera të shkaktuara si rrjedhojë e përpjekjeve të saj për mbledhjen e borxhit apo për arsye tjera;

**1.12. Procedurat për modifikimin e instrumentit ose marrëveshjes për garantim:** duhet të përfshij një kërkesë që çdo ndryshim duhet të jetë me shkrim dhe i nënshkruar nga të gjitha palët në instrumentin ose marrëveshjen e garancisë;

**1.13. Procedurat për pezullimin ose ndërprerjen e instrumentit ose marrëveshjes për garantim:** Një dispozitë që thotë se Banka ose FKGK-ja mund të ndërpresin marrëveshjen me njoftim paraprak dhe siç është dakorduar në Marrëveshjen e Garancisë.

**1.14. FKGK** mund të pezullojë ose të ndërpres instrumentin ose marrëveshjen e garancisë, pas njoftimit paraprak me shkrim prej 10 ditëve të punës tek institucioni i licencuar nëse:

- (a) institucioni i licencuar nuk vepron në përputhje me kushtet e instrumentit ose marrëveshjes së garancisë; ose
- (b) ndodh një ndryshim material i rrethanave që rezultojnë në pamundësi të institucionit të licencuar që të përmbush kërkesat e instrumentit ose marrëveshjes së garancisë, ose për shkak që kushtet janë vendosur fillimisht në instrumentin ose marrëveshjen e garancisë më nuk janë të zbatueshme.

**1.15. Caktimi i instrumentit ose marrëveshjes së garancisë:** një ndalim mbi caktimin e instrumentit apo marrëveshjes së garancisë nga institucioni i licencuar.

**1.16. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve:** Dispozitat përmes së cilave:

- (a) palët do të bëjnë përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore çdo mosmarrëveshje që mund të shfaqet në kuadër të instrumentit ose marrëveshjes së garancisë;
- (b) në qoftë se ata nuk janë në gjendje të arrijnë zgjidhje miqësore, ata do të paraqesin këtë çështje në arbitrazh në Kosovë;
- (d) vendimi i arbitrit ose arbitrazhit do të jetë përfundimtar dhe asnjëra palë nuk do të parashtrij padi kundër palës tjetër në lidhje me ndonjë pjesë të marrëveshjes ose instrumentit të garancisë në përputhje me Ligjin për Arbitrazhin që është në fuqi në Republikën e Kosovës;
- (f) kostot dhe tarifat në lidhje me arbitrazhin do të paguheshin në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fuqi për arbitrazhin në Kosovë;

**1.17. Gjuha e marrëveshjes:** instrumenti apo marrëveshja do të jetë në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast të paqartësisë, do të mbizotërojnë versioni në gjuhën shqipe;

**1.18. Legjislacioni i aplikueshëm:** Një dispozitë që ligjet e Kosovës do të administrojnë dispozitat e marrëveshjes, duke përfshirë çdo mosmarrëveshje që mund të shfaqet në kuadër të instrumentit ose marrëveshjes për garanci;

**1.19. Procedura për dhënien e njoftimeve:** Mjetet e pranueshme të dhënies së njoftimeve të kërkuara nga instrumenti ose marrëveshja e garancisë (të dorëzohen personalisht, përmes korrierit, postës, etj), të adresuar për institucionin e licencuar dhe FKGK-në për të cilën ndonjë njoftim i tillë do t'iu dërgohet, me numrin e telefonit dhe faksit dhe identifikimin (sipas titullit) të personit kontaktues;

**1.20. Mashtrimi, prezantimi i rrejtshëm material, ose aktivitete të paligjshme:** Një dispozitë që nuk do të realizohet asnjë pagesë në kuadër të instrumentit ose marrëveshjes së garancisë për ndonjë humbje që lind nga mashtrimi apo prezantimi i rrejtshëm material për të cilin debitori ose institucioni i licencuar është përgjegjës ose në lidhje me aktivitete të paligjshme nga ana e debitorit ose të institucionit të licencuar;

**1.21. Nuk ka heqje dore të të drejtave të FKGK-së:** Një dispozitë që pagesa në kuadër të instrumentit ose marrëveshjes së garancisë nuk do të konsiderohet heqje dorë nga e drejta e FKGK-së për të kundërshtuar pagesën e tillë të mëvonshme sipas arsyeve të përcaktuara në paragrafin 1.20. të nenit 3 të kësaj rregulloreje, ose ndonjë arsye tjetër e cila do të bëjë pagesën të pavlefshme ose në kundërshtim me dispozitat e instrumentit ose marrëveshjes së garancisë;

**1.22. Ofrimi i informatave:** një dispozitë që institucioni i licencuar do t'i ofroj FKGK-së informacionin e mëposhtëm:

- (a) çdo fakt apo rrethanë që shfaqet pas hyrjes në fuqi të instrumentit ose marrëveshjes së garancisë që materialisht ndikon në instrumentin ose marrëveshjen e garancisë ose largimin e detyrimit të institucionit të licencuar, ose të vërtetën ose saktësinë e ndonjë përfaqësimi mbi të cilat është arritur instrumenti ose marrëveshja për garanci;
- (b) çdo ndryshim i propozuar në formë ligjore të institucionit të licencuar, dhe çdo propozim për shkrirje, blerje, ose ndryshim të kontrollit të institucionit të licencuar ose të debitorit, të paktën 30 ditë para datës së hyrjes në fuqi të ngjarjes së pritshme, duke përfshirë:
  - (i) çdo propozim për blerje, ose shkrirje me një tjetër entitet apo person juridik në mënyrë të tillë që më shumë se dhjetë (10%) të interesave të kapitalit në institucionin e licencuar që rezulton nga blerja apo shkrirja e tillë nuk do të jetë në pronësi nga pronarët e tanishëm, apo nga kompania amë e pronarëve të tanishëm të institucionit të licencuar;
  - (ii) çdo shitje e propozuar e shumicës së interesave të kapitalit në institucionin e licencuar ose ndonjë blerje tjetër nga ndonjë entitet ose person juridik që nuk zotëron të paktën dhjetë përqind (10%) të interesave të kapitalit në institucionin e licencuar që nga data efektive e instrumentit ose marrëveshjes për garanci;
- (c) realizimin final të ndonjë prej pikave të cekura në nën-paragrafin (b) të këtij paragrafi, brenda 5 ditëve të punës pas realizimit të tillë;

- (d) ekzistimi i ndonjë mosmarrëveshje apo procedure ligjore (përfshirë çdo procedure në gjykatë, arbitrazh ose procedura të tjera të ngjashme), të iniciuara ndaj institucionit të licencuar, ndaj kompanisë amë, apo subjekteve të varura të institucionit të licencuar, të cilat, në rast të një vendimi të pafavorshëm, mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e institucionit të licencuar për të kryer obligimet e tij sipas instrumentit ose marrëveshjes së garancisë, sa më shpejt të jetë e mundur (jo më vonë se 3 ditë pune), pasi të njihet me procedurën e tillë;
- (e) Inicimi i çdo procedure të përmbartimit ndaj institucionit të licencuar, ndaj kompanisë amë, apo subjekteve të varura të institucionit të licencuar, ose pasurive të tyre;
- (f) shfaqja e ndonjë rrethanë ose ngjarje që do të përbënte një bazë për pezullimin ose ndërprerjen e instrumentit ose marrëveshjes për garanci, sa më shpejt që të jetë e mundur (jo më vonë se 3 ditë pune), pas njoftimit mbi rrethanën ose ngjarjen e tillë;
- (g) shfaqjen e ndonjë rasti të mos-pagesës në kuadër të marrëveshjes së kredisë ndërmjet debitorit dhe institucionit të licencuar, sa më shpejt që të jetë e mundur (jo më vonë se 3 ditë pune), pas njoftimit mbi rrethanën ose ngjarjen e tillë.

#### **Neni 4 Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 2 maj 2016.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Prof. Dr. Bedri Peci